



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ р./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi _ dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazety Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/2019) dhenenit 40 dhe 41 nga Rregullorja përpunë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi SHSHT.....SHPKNJP eksport-import, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e senacës së 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020, morri

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-5761 nga viti 2019, formuar pas denoncimit nr. 12-5761/1 me datë 24.12.2019 forëzuar nga parashtruesi SHSHT SHPKNJP import-eksport **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën 12-5761 nga viti 2019, në rastin e lëndës vepronë organe tjera kompetente.

Lënda me numër 12-5761 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i Komisionit shtetëror përparandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e KSHPK, në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-5761 nga viti 2019 e formuar pas lajmërimit/denoncimit nr. 12-5761/1 me datë 24.12.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi, person juridik SHSHT..... SHPPNJP, import.eksport

Në denoncim janë shprehur akuza për dyshime për paligjësi dhe korrupsion të bërë në furnizimin publik, të realizuar nga IFKF....., për furnizim të shërbimit "shpërndarje të paketave për vitin e ri 2020 dhe fotografim të fëmijëve me Baba Dimrin", e cila ka qenë realizuar në procedurë për dhënje kontrate për furnizime publike me mbledhje të ofertave pa shpallur shpallje publike.

Parashtruesi i dorëzimit të denoncimit ka qenë një nga pjesmarrësit në procedurën e lëndës deri tek organi i kontraktuar /JOUNDG është dorëzuar ftesë për dorëzim të ofertave me datë 18.11.2019, në të cilën ai iu përgjigj dhe dorëzoi ofertë, mirëpo në procedurë është zgjedhur oferta nga dorëzuesi/operator ekonomik tjetër, dhe për të cilën ofertë ai ka pasur njohuri se ka qenë më e lartë për 50% nga oferta e tyre e ofruar. Parashtruesi i denoncimit, si person i interesuar në procedurë, dyshon në ligjshinë e realizimit të procedurës për furnizime publike, mendon se janë thyer dispozitat ligjore me të cilat rregullohet nënshkrimi i kontratës për furnizime publike pa publikim në shpallje, dhe dyshon se është bërë korrupsion në

procedurën e lëndës gjatë marrjes së vendimit për zgjedhje të ofruesit më të volitshëm. Njëherit, ai dyshon edhe në udhëheqjen transparente të tërë procedurës dhe në paanshmërinë e personit përgjegjës në lëndën IFKF përshkak se është zgjedhur i njëjti ofrues i shërbimit i cili ka qenë zgjedhur edhe në dy-tre vitet e kaluara, edhe pse ai çdo herë ka ofruar çmim më të lartë të shërbimit. Nga ana e personit juridik/parashturs në denoncimin deri te KSHPK, lënda denoncuese është dorëzuar edhe deri në Prokurorinë themelore publike

Gjatë rishikimit të rastit të lëndë, Komisioni shtetëror i merr parasyshtë akuzat në denoncim dhe në drejtim të caktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri në Prokurorinë themeëlore publike për mbledhje të të dhënave, informacioneve dhe dokumentacionit në lidhje me akuzat e lëndës.

Në lidhje me kërkesën e dorëzuar, me datë 19.05.2019, është marrë përgjigje me të cilin KSHPK lajmërohet se në Prokurorinë themelore publike është dorëzuar edhe me shkresë lajmërim/denoncim nga personi i njëjtë juridik pas të cilës në prokurori është vulosur lënda me datë 19.12.2019, është vepruar nga ana e Prokurorsë themelore publike dhe është dhënë urdhër për ndërmarrje të veprimeve nga MPB – SP, pas të cilës procedura vazhdon.

Në bëzë të këtij konstatimi, Komisioni shtetëror përparandalim të korrupsionit vërtetoi se për rastin e lëndës është vepruar nga ana e organi tjetër kompetent PTHP pran së cilës procedura vazhdon, me çka vlerësoi se Komision shtetëror nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke marrë parasyshtë të theksuarën më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Është vendosur me datë 14 Dhjetor 2020, me nr. 12-1914/4

Dorëzuar deri: Arkiva dhe parashtuesi
Pas mbarimit të KSHPK
Puno: J.C., këshilltarë
Miratoi: S. P. D., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËRO R PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Kryetar: Biljana Ivanovska